

ENERGY

**HERONJTË E BJESHKËVE
TË KOSOVËS**



**KUR
NDRIÇOHESHIN
SHTËPITË E PARA
NË KOSOVË!?**

**eKesco
ME KATËR SHËRBIME
TË REJA**

**EFEKTET E
AKTIVITETEVE TË
PËRGJEGJËSISË
SHOQËRORE**

Përmbajtja / Contents

ENERGY

4-7 Ngjarjet që karakterizuan KEDS/KESCO / *The events that characterized KEDS / KESCO*

Op-Ed

8-9 Sistemi Elektroenergjetik i Kosovës / *Kosovo Power System*

ENERGY

10-13 Heronjtë e bjeshkëve të Kosovës / *Heroes of the mountains of Kosovo*

ENERGY

14-15 Roli i KEDS dhe KESCO në pavarësimin elektroenergjetik të Kosovës / *The role of KEDS and KESCO in Kosovo's electricity independence*

KEDS ACADEMY

16-21 KEDS Academy vazhdon rrugëtimin / *KEDS Academy continues its journey*

INVESTIME

22-24 Digjitalizohet komplet rrjeti elektrik i tensionit të mesëm / *The medium voltage electrical network gets digitalized completely*

KOMUNITETI

26-29 Efektet e aktiviteteve të përgjegjësisë shoqërore / *Effects of social responsibility activities*

ENERGY

30-31 eKesco me katër shërbime të reja / *eKesco with four new services*

KOMUNITETI

32-35 Përgjegjësia Shoqërore e Korporatës / *Corporate Social Responsibility*

HISTORI

36-40 Kur ndriqoheshin shtëpitë e para në Kosovë!? / *When the first houses in Kosovo were lit!?*

KULTURA

42-45 Libri, efekti pozitiv i pandemisë në Kosovë / *The book, the positive effect of the pandemic in Kosovo*

SPORT REKREATIV

46-49 Alpinistët kosovarë që po sfidojnë pandeminë / *Kosovar alpinists challenging the pandemic*

ARGËTIM

50-53 Fakte energjetike për fëmijë / *Energy facts for kids*

PËR FËMIJËT TANË

54 Gjeni 10 dallimet ndërmjet dy fotove / *Find 10 differences between two pictures*

NGJARJET QË KARAKTERIZUAN KEDS/KESCO



Punimet
NË RRJET
në kohë
REALE
përmes
eKesco

Qysh në ditët e para të këtij viti, KEDS mobilizoi qindra punëtorë terreni për të qenë në gjendje gatishmërie për të intervenuar në rast se paraqitet nevoja pas rënies drastike të temperaturave dhe përkeqësimit të motit që goditi vendin.

Derisa në njërin anë ekipet tona të terrenit po bënin punë të shkëlqyeshme në terren, në Prishtinë tashmë kishte filluar rrugëtimin e ri KEDS Academy, që do të mirëpriste mbi 60 nxënës/studentë të rinj. Njëkohësisht, përgjatë gjithë kësaj kohe, KEDS vazhonte investimet në mirëmbajtje dhe përforsim të rrjetit, për të mundur furnizim stabil dhe kualitativ për konsumatorët tanë. Të njëjtën kohë, për konsumatorët po përgatitej një platformë e re informimi, ueb-faqet e KEDS/KESCO po bëheshin gati për lansimin final me një dizajn komplet të ri, në të cilin do të shpaloseshin shumë risi.

Në vijim, kemi renditur disa nga ngjarjet kryesore që karakterizuan kuadrantin e parë të vitit 2021:

In the first days of this year, KEDS mobilized hundreds of field workers to be ready to intervene in case the need arises after the drastic drop in temperatures and wors weather that hit the country.

While on the one hand our field teams were doing excellent field work, in Prishtina the new KEDS Academy journey had already begun, which would welcome over 60 new pupils/ students. Throughout this time, KEDS continued to invest in network maintenance and reinforcement, to enable a stable and quality supply for our customers. At the same time, a new information platform was being prepared for consumers, KEDS/KESCO websites were getting ready for the final launch with a completely new design, in which many innovations would be unveiled.

The following are some of the key events that characterized the first quarter of 2021:

THE EVENTS THAT CHARACTERIZED KEDS / KESCO



KEDS mobilizon qindra ekipe terreni pas përkeqësimit të motit

Fillimi i vitit 2021 ishte mjaft sfidues për ekipet e terrenit. Ata u ballafaquan me kushte jashtëzakonisht të rënduara, ku temperaturat e ulëta dhe acari i janarit vështirësuan intervenimet në rrjet. Përkundër kësaj, ekipet e KEDS nuk u ndalën asnjëherë deri në sanimin e plotë të dëmeve të shkaktuara nga kushtet atmosferike, duke rikthyer kështu furnizimin për të gjithë konsumatorët e afektuar.

KESCO lansoi katër shërbime të reja

KESCO përmes aplikacionit të saj e-Kesco ka lansuar edhe katër shërbime të reja, që tashmë janë në dispozicion falas për konsumatorët kudo që gjenden. Duke shërbyer si platformë me qasje të lehtë dhe të shpejtë në shërbimet e kompanisë, ky aplikacion mundëson përdoruesit nga e gjithë bota të dërgojnë kërkesa dhe ankesa online, të bëjnë llogaritjen e përafërt të pajisjeve shtëpiake, të shohin në hartë të gjitha punimet e planifikuara dhe të raportojnë ndërprerjet e energjisë elektrike.

KEDS mobilizes hundreds of field teams following worsening weather

The start of 2021 was quite challenging for the field teams. They faced extremely severe conditions, with low temperatures and January frost making network interventions difficult. Despite this, KEDS teams never stopped until the complete repair of the damages caused by the atmospheric conditions, thus restoring the supply to all the affected customers.

KESCO launched four new services

KESCO, through its e-Kesco application has launched four new services, which are now available for free to customers everywhere. Serving as a platform with easy and fast access to the company's services, this application enables users from all over the world to send requests and complaints online, do rough calculations of home appliances, see on the map all the planned works and report power outages.

Nisën ligjëratat e KEDS Academy VIII

Sivjet, programin profesional dhe akademik 1 -vjeçar po e ndjekin 61 kandidatë, të cilët vijnë me profile të ndryshme anekënd Kosovës. Kandidatët e përzgjedhur i përgëzoi edhe Kryeshefi Ekzekutiv i KEDS, Alper Erbas, i cili iu uroi mirëseardhje. Për dallim nga vitet e kaluara, këtë vit për shkak të situatës pandemike, kandidatët programin po e ndjekin virtualisht, nga distanca duke respektuar udhëzimet e institucioneve shëndetësore për parandalimin e përhapjes së Covid-19.

The lectures of KEDS Academy VIII started

This year, the 1-year professional and academic program is being attended by 61 candidates, who come with different profiles throughout Kosovo. The selected candidates were also congratulated by the Chief Executive Officer of KEDS, Alper Erbas, who welcomed them. Unlike previous years, this year due to the pandemic situation, candidates are following the program virtually, remotely following the instructions of health institutions to prevent the spread of Covid-19.



Ambasadori Minxhozi priti në takim Kryeshefin Ekzekutiv, z. Erbaş

Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, z. Minxhozi priti në takim mikpritës kryeshefin ekzekutiv të KEDS, z. Alper Erbaş. Bashkëbiseduesit vlerësuan bashkëpunimin aktual shumë të mirë në fushën energjetike, si dhe diskutuan për projekte konkrete të përbashkëta në funksion të thellimit dhe zgjerimit të tij.

KEDS vazhdon investimet në rrjet

Përkundër pandemisë KEDS nuk u ndal me investimet në rrjet. Kyçja e konsumatorëve në rrjet të ri dhe energjizimi i rrjetit të ri po mundëson që konsumatorët tanë të përfitojnë shërbime dukshëm më kualitative dhe furnizim më stabil me energji elektrike. Punën nuk po e ndalin as kontraktorët e KEDS, të cilët po vazhdojnë të krijojnë infrastrukturën e nevojshme në terren për shtrirjen e kabllove të reja nëntokësore. Investimet po vazhdojnë sipas planifikimeve derisa pas përfundimit të tyre, konsumatorët tanë do të përfitojnë shërbime moderne dhe kualitative. KEDS prezanton ueb-faqen me dizajn tërësisht të ri. Me qëllim që të jemi sa më afër konsumatorit, uebfaqja e

Ambassador Minxhozi hosted the meeting with the Chief Executive Officer, Mr. Erbaş

The Ambassador of Albania in Kosovo, Mr. Minxhozi received in a meeting the Chief Executive Officer of KEDS, Mr. Alper Erbaş. The interlocutors praised the current very good cooperation in the field of energy, as well as discussed concrete joint projects in order to deepen and expand the cooperation.

KEDS continues to invest in the network

Despite the pandemic, KEDS did not stop investing in the network. Connecting customers to the new network and energizing the new network is enabling our customers to benefit from significantly better services and more stable electricity supply. KEDS contractors are not stopping the work either, as they are continuing to create the necessary infrastructure on the ground for the laying of new underground cables. Investments are continuing as planned until after their completion, our customers will benefit from modern and quality services. KEDS presents the website with a completely new design. In order to be as close as possible to the customer, the new



re do të ofrojë shumë risi. Duke iu ofruar një paraqitje grafike ndryshe, që fuqishëm mbështetë identitetin e kompanisë, konsumatorët do të marrin informatat e fundit, të sakta përmes ueb-faqes së re.


KESCO ofroi furnizim stabil për ditën e zgjedhjeve

Furnizimi me energji elektrike gjatë ditës së zgjedhjeve ishte stabil dhe pa ndërprerje. Kjo, pasi që KESCO kishte siguruar importin shtesë për ta mbuluar GEP-in ndërmjet kërkesës dhe prodhimit. E kërkesa, për shkak të acarit të madh, ishte ndër më të mëdhatë në histori të energjetikës kosovare.

website will offer many innovations. By offering a different graphic representation that strongly supports the company identity, customers will receive the latest, accurate information through the new website.

KESCO provided stable supply for Election Day

Electricity supply on Election Day was stable and uninterrupted. This, as KESCO had provided additional imports to cover the gap between demand and production. And the demand, due to the great frost, was among the largest in the history of Kosovo energy field.



**KEDS
ACADEMY**

KEDS mobilizoi mbi 1300 punëtorë për zgjedhje

KEDS gjatë asaj dite kishte mbi 1300 punëtorë të angazhuar në terren të cilët u siguruan që shpërndarja e energjisë elektrike të jetë stabile në qendrat e votimit anekënd vendit. Krahas kësaj, KEDS kishte vënë në dispozicion në qendrat e votimit rreth 1000 bateri emergjente, që ishin të gatshme të përdoshin në rast nevojë. Në dispozicion për qendrat e votimit ishin edhe 70 gjeneratorë mobil për t'u shfrytëzuar në rast të ndonjë të papriturë në rrjet, në mënyrë që mbarëvajtja e procesit të votimit të vijojë sipas planifikimeve. Furnizimi me energji elektrike gjatë ditës së zgjedhjeve u monitorua në kohë reale përmes programit më të avancuar Kosovanet dhe sistemit për kontrollimin e nënstacioneve SCADA, që ofroi të dhëna të detajuara për secilën situatë të krijuar në terren.

KEDS mobilized over 1300 workers for elections

KEDS during that day had over 1300 field workers who ensured that the distribution of electricity was stable in the polling stations across the country. In addition, KEDS had made available at the polling stations about 1000 emergency batteries, which were ready to be used in case of need. There were also 70 mobile generators available for the polling stations to be used in case of any network problems, so that the voting process could proceed as planned. Electricity supply during Election Day was monitored in real time through the state-of-the-art Kosovanet program and the SCADA substation control system, which provided detailed data on each situation created on the ground.



SISTEMI ELEKTROENERGJETIK I KOSOVËS

KOSOVO POWER SYSTEM

Shkruan Mr.Sc.E.Eng Avni Alidemaj,
Zyrtarë i Pajtueshmërisë / Compliance Officer


Sistemi energjetik i një vendi nuk është i lehtë për t'u kuptuar dhe menaxhuar. Natyra e ndërlikuar e teknikës së përdorur sot paraqet sfidë të vërtetë për realizimin e duhur të punëve në këtë sistem. Sistemi energjetik i Kosovës përveç natyrës teknike të rëndomtë, ka qenë prej kohësh dhe mbetet edhe më tej specifik, kjo duke pasur parasysh historinë e punës së këtij sistemi.

Realiteti është i tillë, që për të pasur sukses një sistem i tërë energjetik duhet të jenë të suksesshme dhe funksionale katër komponentë që nuk bëjnë pa njëra-tjetrën.



A country's energy system is not an easy system to understand and manage. The complex nature of the technique used today poses a real challenge to the proper performance of work in this system. Kosovo energy system, in addition to the ordinary technical nature, has long been and remains specific, given the working history of this system.

The reality is that in order for an entire energy system to be successful, four components must be successful and functional that do not do without each other.



Këto komponente janë:

- ⚡ Prodhim i mjaftueshëm dhe permanent i energjisë elektrike,
- ⚡ Objekte të mjaftueshme dhe plotësisht funksionale energjetike për transmision dhe shpërndarjen e energjisë elektrike nga pika e prodhimit deri te konsumatori i fundit,
- ⚡ Plasim i sigurt i tërë energjisë së prodhuar në vend me çmime që reflektojnë koston dhe tregun vendor e rajonal,
- ⚡ Infrastruktura e fortë dhe funksionale ligjore që mbron çdo kilovat/h të shpërndarë deri te konsumatori i fundit dhe anasjelltas.

Aktualisht, energjia elektrike e prodhuar në vendin tonë nga termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B" nuk është e mjaftueshme për të ngopur konsumin vendor me energji elektrike, çka do të thotë se duhen burime të reja për prodhimin e energjisë elektrike (duke pasur parasysh lëndën e parë që ka vendi ynë). Në një situatë të tillë do të duhet një vetëdije më e ngritur e konsumatorit dhe asaj institucionale për rëndësinë e megavatëve prodhuar dhe të shpërndarë te konsumatori dhe respektimin e obligimeve që ka konsumatori për produktin që i servohet në shtëpi, zyrë apo çfarëdo objekti tjetër nga KEDS.

Në KEDS janë shënuar zhvillime tejet pozitive dhe inkurajuese si në fushën e operimit, mirëmbajtjes, po ashtu edhe në atë të investimeve në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

Janë ndërtuar objekte të reja energjetike të të gjitha niveleve (pjesa që i takon KEDS-it) në shpërndarje të energjisë elektrike si dhe janë ngritur rrjete të reja. Këto investime kanë bërë që konsumatorët të kenë furnizim me të besueshëm dhe më kualitativ me energji elektrike. KEDS është duke vazhduar me investime, që si rezultat final kanë furnizimin permanent dhe cilësor të konsumatorëve me energji elektrike.

Suksesi në një kompanie nënkupton shumëçka dhe e tërë ajo që përfshihet në këtë fjalë të vetme nënkupton planifikim dhe angazhim profesional të orientuar drejt realizimit të objektivave, dhe nëse më pyesni, nëse jemi të aftë dhe mund të arrijmë sukses në kohët që po na presin para, përgjigjja ime e menjëhershme dhe e pa-reservë do të ishte se po, jemi të aftë dhe mundemi dhe suksese të reja do të arrihen.

Suksese!

These components are:

- ⚡ Sufficient and permanent generation of electricity,
- ⚡ Sufficient and fully functional energy facilities for transmission and distribution of electricity from the point of generation to the final consumer,
- ⚡ Safe placement of all locally produced energy at prices that reflect the cost and the local and regional market,
- ⚡ Strong and functional legal infrastructure that protects every kilowatt/h distributed to the final consumer and vice versa.


Currently, the electricity produced in our country by the power plants "Kosova A" and "Kosova B" is not sufficient to saturate local consumption with electricity, which means that new sources are needed for electricity production (given the raw material that our country has). In such a situation, a higher consumer and institutional awareness will be needed about the importance of megawatts produced and distributed to the consumer and the observance of the obligations that the consumer has for the product served at home, office or any other facility by KEDS.

Extremely positive and encouraging developments have been recorded in KEDS, both in the field of operation, maintenance, as well as in the investments in the electricity distribution network.

New energy facilities of all levels (part belonging to KEDS) have been built in the distribution of electricity and new networks have been set up. These investments have enabled consumers to have a more reliable and quality supply of electricity. KEDS is continuing with investments, which as a final result have a permanent and quality supply of electricity to consumers.

Success in a company means a lot and all that is included in this single word means planning and professional commitment oriented towards achieving the objectives, and if you ask me, if we are capable and can achieve success in the times ahead of us, my immediate and unreserved response would be that yes, we are capable and we can, and new successes will be achieved.

Success!



HERONJTË E BJESHKËVE TË KOSOVËS

HEROES OF THE MOUNTAINS OF KOSOVO

Punëtorët e KEDS të terreneve sfiduese i gjen në Shalë të Bajgorës, Bjeshkët e Sharrit apo malet e Gollakut. Vazhdimisht në aksion, për t'ua rikthyer energjinë elektrike konsumatorëve aty ku është e nevojshme. Heronjtë e bjeshkëve rrëfejnë si arrijnë ta mposhtin acarin, erërat e fuqishme dhe borën e madhe.

Petrit Nikçi e arsyeton emrin e tij edhe në praktikë. Sa herë që ndodhë ndonjë prishje në rrjetin elektrik që shtrihet përgjatë Bjeshkëve të Nemuna, ai është aty, duke i pushtuar lartësitë. "Nuk i mendoj vështirësitë asnjëherë. Ku ka më mirë se më ua lëshu rrymën njerëzve, sidomos në kohë të keqe", thotë Petriti, teksa udhëheqë ekipin e tij në tatëpjetat e Rugovës. E dinë që është një rrugë e largët, ku të vetmet gjurmë që shiheshin ishin ato të ndonjë kafshe të egër, që kishte përshkuar terrenin më herët andejpari. Bora kishte arritur në 1 metër lartësi. Ekipi i KEDS çan shtegun përpara, secili me disa kilogramë pajisje në shpinë. Pas tri orë ecje të vështirë, arrijnë në vendin e defektit. Nga erërat e fuqishme të shoqëruara me reshje të mëdha janë rrëzuar tri shtylla elektrike. "Kjo trase duhet të pastrohet! Degët kanë prekur largpërçuesin dhe kjo ka lënë njerëzit pa energji elektrike.



KEDS workers find challenging terrains in Shala of Bajgora, Sharr Mountains or Gollak mountains. Constantly in action, to reinstate electricity supply to customers where needed. The heroes of the mountains tell how they manage to defeat the frost, the strong winds and the big snow.

Petrit Nikci justifies his name in practice. Whenever there is a breakdown in the power grid that stretches along the Cursed Mountains, he is there, conquering the peaks. "I never think about difficulties," he said. "There is no better way than the way to reinstate the electricity power to the people, especially in bad times", says Petriti, while leading his team on the slopes of Rugova.



**Nuk i mendoj vështirësitë asnjëherë. Ku ka më mirë se më ua lëshu rrymën
njëzëve, sidomos në kohë të keqe**

***I never think about difficulties. There is no better way other than to reinstate the
electricity power to the people, especially in bad times***

Petrit Nikçi, udhëheqës i ekipit në Operime



They know that it is a distant road, where the only traces that were seen were those of some wild animal, which had crossed the terrain earlier there.

The snow had reached a height of 1 meter. The KEDS team plows the path forward, each with a few pounds of equipment on its back. After three hours of hard walking, they reach the site where the failure occurred. Three electric poles were knocked down by strong winds accompanied by heavy rainfall.

"This route must be cleaned! The branches have touched the transmission line and this has left people without electricity. Let's get to work", the team leader is heard to say. They first secure the perimeter to make sure everything is secure, then get to work.

It is Petrit who shows leadership in practice. He climbs first on the pole located on a steep bank to fix the problem. Assisted by his KEDS colleagues. Solidarity is at a maximum. This is also necessary, as the challenging terrain was helped by strong winds, accompanied by snow and harsh weather, which made it difficult to work to the maximum. But, they do not stop. Not until they fix the defect and return the electricity to the customers.

"You see, it is difficult, but we have never given up. It happens sometimes we do not manage to fix the problem immediately due to extreme weather conditions. We feel bad in those cases. Then we mobilize, we can hardly wait to go there again and fix the problem. We always have our minds and hearts there", says Petriti.

Others unanimously approve of his words: "Yes, that's right." There are four mountains of Kosovo, all electrified, with the network that is distributed hundreds of kilometres within them.



T'i përvishemi punës", dëgjohet tek thotë udhëheqësi i ekipit. Ata fillimisht sigurojnë perimetrimin që të jetë gjithçka e sigurt, pastaj i përvishen punës.

Është Petriti i cili tregon udhëheqjen edhe në praktikë. Ai hip i pari mbi shtyllë që gjendet në një breg të thepisur që të sanojë problemin. Ndihmohet nga kolegët e tij të KEDS. Solidarizimi është në maksimum. Kjo është edhe e domosdoshme, pasi terrenit sfidues i ndihmonin edhe erërat e fuqishme, të shoqëruara me borë dhe mot të acartë, që e vështirësuan punën në maksimum. Por, ata nuk ndalen. Jo derisa ta rregullojnë defektin dhe t'ua kthejnë energjinë elektrike konsumatorëve.



"E shihni, është vështirë, por nuk jemi dorëzuar asnjëherë. Ndodhë ndonjëherë nuk ia arrijmë ta rregullojmë problemin menjëherë për shkak të kushteve ekstreme atmosferike. Ndihej keq në ato raste. Pastaj mobilizohemi, mezi s'presim që të shkojmë sërish atje dhe ta rregullojmë problemin. Mendjen e zemrën e kemi gjithmonë aty", thotë Petriti. Të tjerët njëzëri ia miratojnë fjalët: "Po, qashtu është". Janë katër bjeshkë të Kosovës, të gjitha të elektrifikuara, me rrjetin që shpërndahet qindra kilometra brenda tyre. Mirëmbajtja e tyre bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Por, faktorët atmosferik në kombinim me konfiguracionin e terrenit e bëjnë të veten.

Their maintenance is done continuously. But, atmospheric factors in combination with the terrain configuration make it hard.

You can find KEDS workers in challenging terrains in Shala of Bajgora, Sharr Mountains or Gollak mountains. Constantly in action, to return electricity to customers where needed.

The location that includes the largest number of customers in areas with high altitude is that of Dragash. There, Vetim Shabani is always ready together with his colleagues.

"It is difficult terrain, but we are used to it. Willpower is added to us when we know our mission. It is an extraordinary feeling in those conditions to reinstate electricity supply to consumers", says Vetim.

Është terren i vështirë, por jemi mësuar. Vullneti na shtohet kur e dimë misionin tonë. Ndjenjë e jashtëzakonshme është kur në ato kushte ua kthen energjinë elektrike konsumatorëve.

It is difficult terrain, but we are used to it. Willpower is added to us when we know our mission. It is an extraordinary feeling in those conditions to reinstate electricity supply to consumers

Vetim Shabani, udhëheqës i ekipit në Operime

Punëtorët e KEDS të terreneve sfiduese i gjen në Shalë të Bajgorës, Bjeshkët e Sharrit apo malet e Gollakut. Vazhdimisht në aksion, për t'ua rikthyer energjinë elektrike konsumatorëve aty ku është e nevojshme. Lokaliteti që përfshinë numrin më të madh të konsumatorëve në zonat me lartësi të madhe mbidetare është ajo e Dragashit. Aty, gjithmonë i gatshëm së bashku me kolegët e tij është Vetim Shabani.

"Është terren i vështirë, por jemi mësuar. Vullneti na shtohet kur e dimë misionin tonë. Është ndjenjë e jashtëzakonshme në ato kushte me ua kthyer energjinë elektrike konsumatorëve", thotë Vetimi.

Sa herë ndodhë ndonjë e papritur, ai mobilizohet së bashku me kolegët e tij që të tejkalojnë çdo sfidë. Dëshira për të qenë afër qytetarëve në secilën situatë është e palëkundur. Entuziazmi dhe përgatitja maksimale e tyre sfidon në vazhdimësi si tatëpjetat e rrezikshme, ashtu edhe erërat e fuqishme, borën, shiun apo acarin.

Jo rrallëherë, kur bora kalon mbi 1 metër dhe ndodhë prishja në zonë pa shteg për automjete, me qindra metra t'i bartin shtyllat vet, pasi nuk ka asnjë alternativë që makineria të arrijë aty. E bëjnë këtë me vullnetin më të madh.

"Momenti i triumfit, kur ne arrijmë ta energjizojmë daljen është i papërshkrueshëm. Atëherë harrojmë secilin mundim, secilën sfidë apo vështirësi. Është moment çlirimi", thekson Vetimi. Ndjenjë e njëjtë është edhe për punëtorët të cilët operojnë në Shalë të Bajgorës apo Gollak. Triumfi ndaj acarit është gjithmonë i ngrohtë.

Whenever something unexpected happens, he mobilizes together with his colleagues to overcome any challenge.

The desire to be close to the citizens in every situation is unwavering.

The dangerous slopes as well as strong winds, snow, rain or frost are constantly challenged by their enthusiasm and maximum preparation.

Not infrequently, when the snow passes over 1 meter and the breakdown occurs in the area without a path for vehicles, hundreds of meters to carry the poles themselves, as there is no alternative for the machinery to get there. They do this with the greatest will.

"The moment of triumph, when we manage to energize the feeder, is indescribable. Then we forget every hardship, every challenge or difficulty. It is a moment of relief", emphasizes Vetim.

The same feeling is for the workers who operate in Shala of Bajgora or Gollak. Triumph over frost is always warm.



ROLI I KEDS DHE KESCO NË PAVARËSIMIN ELEKTROENERGJETIK TË KOSOVËS

THE ROLE OF KEDS AND KESCO IN KOSOVO'S ELECTRICITY INDEPENDENCE

Sasinë e plotë të importit kishte arritur ta siguronte KESCO. Kjo ishte bërë pas gjetjes së rrugëve komerciale me kompanitë partnere të importit. Ndërsa, KEDS kishte arritur ta bënte shpërndarjen e komplet kësaj energjie te konsumatorët përmes rrjetit distributiv.

Pikërisht 14 dhjetori ishte pika e kthesës në energjetikën kosovare. Atë ditë, ndodhi pavarësimi i saj dhe krijimi i bllokut elektroenergjetik me Shqipërinë.

Por, kjo rrugë nuk ishte aspak e lehtë. Në angazhimin e të gjitha palëve, u desh të bëhen përgatitje maksimale edhe nga ana e KEDS dhe KESCO. "Krijimi i rrugëve alternative komerciale ishte sfidë në vete. Nevojitet mbulimi i GEP-it ndërmjet konsumit dhe prodhimit, për çka ia arritëm ta bënim me sukses të plotë.", thotë Behije Ahmeti, Drejtoreshë për Tregtim të Energjisë në KESCO.

Sasinë e plotë të importit kishte arritur ta siguronte KESCO. Kjo ishte bërë pas gjetjes së rrugëve komerciale dhe negociatave të vazhdueshme, marrëveshjeve të Qeverisë së Kosovës me qeveritë e Shqipërisë dhe Maqedonisë

KESCO managed to provide the full amount of imports. This was done after finding commercial routes with partner import companies. Whereas, KEDS had managed to make the complete distribution of this energy to consumers through the distribution network.

Exactly December 14 was the turning point in Kosovar energetics. That day, its independence took place and the creation of the power block with Albania took place. But, this road was not easy at all. In the commitment of all parties, maximum preparations had to be made by KEDS and KESCO. "Creating alternative commercial routes was a challenge in itself. Gap coverage between consumption and production is needed, for which we managed to do it with complete success", says Behije Ahmeti, Director of Trade at KESCO.

The full amount of imports had been provided by KESCO. This was done after finding commercial routes and ongoing negotiations, agreements of the Government of Kosovo with the governments of Albania and Macedonia and the direct

"Së bashku ia dolëm t'i tejkalojmë të gjitha sfidat. Nuk ishte e lehtë, por kur sinkronizohen përpjekjet maksimale të të gjithëve, suktesi nuk ka si të mungojë"

Behije Ahmeti, Drejtoreshë për Tregtim të Energjisë në KESCO

dhe angazhimit direkt të KESCO-s me kompanitë partnere të importit. Të njëjtën kohë KEDS kishte arritur ta bënte shpërndarjen e komplet kësaj energjie te konsumatorët përmes rrjetit distributiv. Kjo përgatitje maksimale dhe angazhimi i madh i dy kompanive kishte bërë që energjetika kosovare të paraqitej si serioze para komunitetit ndërkombëtar që përfaqësohet në ENTSO.

“Çdo gjë që ka kërkuar KOSTT-i nga ne, e kemi realizuar komplet”, thotë Ahmeti.

Si shenjë falënderimi dhe bashkëpunimi të shkëlqyeshëm, KOSTT ka shpërblyer me mirënjohje të dy kompanitë, si KEDS-in, ashtu edhe KESCO-n.

“Së bashku ia dolëm t’i tejkalojmë të gjitha sfidat. Nuk ishte e lehtë, por kur sinkronizohen përpjekjet maksimale të të gjithëve, suksesi nuk ka si të mungojë”, shton Ahmeti. Për një kohë të gjatë, që nga paslufta Serbia shiste kapacitetet e KOSTT-it si të sajat. Por, kjo ndryshoi përfundimisht dhe tashmë kapacitetet transmetuese të kësaj kompanie menaxhohen nga Kosova dhe në tregun ndërkombëtar elektroenergetik njihen si të Kosovës. Rëndësia e pavarësisht elektroenergetik rritet për faktin se tashmë linja 400 kV Kosovë- Shqipëri është komplet funksionale. Të njëjtën kohë, krijimi i bllokut të përbashkët forcon pozicionimin energjetik të dy vendeve. Ndërkohë, Serbia pritët t’i përmbushë obligimet e saj ndërkombëtare karshi ENTSO-s.

Transmisioni është pjesë e sistemit elektroenergetik të Kosovës që përbëhet nga katër akterë kryesor. Ai menaxhohet nga KOSTT. Ndërlidhja bëhet me rrjetin distributiv në anën tjetër që menaxhohet nga KEDS-i, prej nga furnizohen me energji elektrike konsumatorët nga KESCO, si furnizues publik.

Në anën tjetër, ai ndërlidhet me KEK-un si prodhuesi kryesor i energjisë elektrike në vend, duke kompletuar katërshen kryesore të zinxhirit elektroenergetik.



engagement of KESCO with partner import companies. At the same time KEDS had managed to make the complete distribution of this energy to consumers through the distribution network. This maximum preparation and the great commitment of the two companies had made Kosovar energy appear serious before the international community represented in ENTSOE.

"Everything that KOSTT has asked of us, we have completely realized", says Ahmeti.

As a sign of gratitude and excellent cooperation, KOSTT has gratefully awarded both companies, KEDS and KESCO.

"Together we managed to overcome all the challenges. It was not easy, but when the maximum efforts of everyone are synchronized, success cannot be lacking", adds Ahmeti. For a long time, since the post-war period, Serbia has been selling KOSTT's capabilities as its own. But, this finally changed and now the transmission capacities of this company are managed by Kosovo and in the international electricity market are known as Kosovo capacities.

The importance of electricity independence increases due to the fact that the 400 kV line Kosovo-Albania is now fully functional. At the same time, the creation of the joint bloc strengthens the energy positioning of the two countries. Meanwhile, Serbia is expected to meet its international obligations to ENTSOE.

Transmission is part of Kosovo's power system consisting of four main actors. It is managed by KOSTT. The connection is made with the distribution network on the other hand managed by KEDS, from where the customers are supplied with electricity by KESCO, as a public supplier.

On the other hand, it connects with KEK as the main producer of electricity in the country, completing the top four of the electricity chain.



KEDS ACADEMY

VAZHDON RRUGËTIMIN

KEDS ACADEMY CONTINUES
ITS JOURNEY



Është viti i dytë që kur programi i KEDS Academy po zhvillohet në platformën online, duke i respektuar dhe përmbajtur të gjitha rregullave anti Covid.

Këtë vit KEDS ka startuar me gjeneratën e VIII dhe janë 20 studentë dhe 40 nxënës që aktualisht po ndjekin programin akademik e profesional të këtij projekti. KEDS ka siguruar të gjitha pajisjet teknike dhe platformat e nevojshme që këto ligjërata të zhvillohen në instanca normale.

Temat e para që u zhvilluan për grupet e pjesëmarrësve u mbajtën nga stafi i KEDS-it dhe kishin të bëjnë me menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe për ligjet e detyrat e kompanisë, duke vazhduar pastaj me Siguria dhe Shëndeti në Punë e tema tjera sipas planprogramit.

Demonstrimin praktik për pajisjet energjetike studentët e kanë bërë në Qendrën e Trajnimit të KEDS, ku janë të improvizuara stabilimentet dhe shumë lloje të shtyllave dhe trafove.

Ata kanë parë nga afër pajisjet elektrike dhe funksionin e tyre duke i praktikuar edhe vetë.

It's the second year since the KEDS Academy program is being held online by adhering and respecting all anti Covid-19 rules.

This year KEDS has started with the VIII generation and there are 20 students and 40 pupils who are currently participating the academic and professional program of this project.

KEDS has provided all the necessary technical equipment and platforms for these lectures to be held in normal instances. The first topics that were developed for the groups of participants were held by KEDS staff which were related to Human Resources management and company laws and duties, followed by Safety and Health at Work and other topics according to the curriculum.

The students demonstrated the practical demonstration of energy equipment at the KEDS Training Center, where the facilities and many types of poles and transformers are improvised.



Për Mustafën ishte hera e parë që shihte gjithë këto pajisje energjetike dhe është shprehur mjaft i impresionuar dhe falënderues për këtë mundësi. "Ishte shumë interesante për mua të shoh të gjitha pajisjet elektrike në një vend. Dhe jam shumë i kënaqur që në të ardhmen mësimet e marra këtu do të më ndihmojnë profesionalisht. Falënderoj shumë KEDS-in për këtë mundësi", ka thënë nxënësi, Mustafë Mirena.

Donikë Jupaj nuk e sheh prioritet punësimi në KEDS, ajo është e kënaqur për aftësimin dhe përvojën e sidomos për praktikën që do të zhvillojë gjatë këtij programi.

"Nga kjo Academy po mësoj për gjërat që nuk i kam mësuar në fakultet, pres të aftësohem për tregun e punës. Kurse nga pjesa praktike mendoj që do të marr një përvojë që do të më ndihmojë në të ardhmen profesionalisht. Edhe nëse në të ardhmen nuk do të jem pjesë e KEDS, kjo përvojë do të më ndihmojë për t'u punësuar diku tjetër", Donika Jupaj, studente e inxhinierisë elektrike.

They have seen closely the electrical equipment and their function by practicing them themselves. It was the first time for Mustafa to see all the electrical equipment and he was very impressed and grateful for this opportunity.

"It was very interesting for me to see all the electrical equipment in one place. And I am very pleased that in the future the lessons learned here will help me professionally. I thank KEDS for this opportunity", said Mustafë Mirena - pupil.

Although Donikë Jupaj does not see employment in KEDS as a priority, she is very satisfied with the training, experience and especially for the internship that she will develop during this program. "At KEDS Academy I am learning about things I did not learn in college and I look forward to being trained for the job market. From the practical part, I think I will get an experience that will help me professionally in the future. Even if in the future I will not be part of KEDS, this experience will help me to be employed elsewhere",

Burim Islami ka qenë edhe vetë pjesë e KEDS Academy, tani trajner në KEDS, ka këshilluar nxënësit që të kenë kujdes nga rreziqet e mundshme në vendin e punës dhe të ruajnë shëndetin. “Gjatë këtyre ligjëratave studentët u njohën me ligjet dhe rregulloret në fuqi përmes të cilave është e rregulluar fusha e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në Kosovë dhe në vetë kompaninë KEDS, si dhe mbi rreziqet e mundshme, me ç’rast ata u këshilluan se si të mbrohen në vendin e punës duke u informuar mbi mënyrat dhe metodat për mbrojtje nga energjia elektrike. Si gjithmonë duke i porositur ata: Shëndeti mbi të gjitha!”, ka thënë Burimi. Aktualisht grupi i studentëve po ndjekin ligjëratat online me stafin e Universitetit Boğaziçi.

Donika Jupaj, student of electrical engineering. Burim Islami, who was also part of the KEDS Academy, now a trainer at KEDS, advised students to beware of potential risks in the workplace and to maintain their health. “During these lectures, the students were taught with the laws and regulations in force through which the field of Occupational Safety and Health in Kosovo and in the company KEDS is regulated, as well as on the possible risks in which case they were advised how be protected in the workplace by being informed about the ways and methods for protection from electricity. As always by advising them: Health above all!”, Said Burim. Currently the group of students are attending online lectures with the staff of Boğaziçi University.



Shemsije Lahu

Udhëheqëse për Trajnim dhe Zhvillim në KEDS

Për mbarëvajtjen e projektit si dhe organizimin e moduleve të programit të lidershit dhe atë teknik, na ka treguar edhe Udhëheqësja për Trajnim dhe Zhvillim në KEDS, Shemsije Lahu.

“Për dallim nga gjeneratat tjera, dy gjeneratat e fundit, e VII dhe VIII për shkak të rrethanave të krijuara me pandeminë u organizuan ndryshe (sipas udhëzimeve të diktura nga Komisioni për Emergjencë) duke adaptuar mjete të ndryshme trajnimi dhe duke qëndruar kështu brenda planifikimit të programit si çdo vit. Kjo nuk e ndaloi aspak ecurinë dhe rezultoi po aq e suksesshme. Tanimë me gjeneratën e VIII nga përvoja e vitit të kaluar e kishim më të lehtë dhe po ashtu kishim mundësinë të eksperimentojmë edhe me modulet duke sjellë gjithmonë risi dhe rifreskim në programe. Organizimi ndryshe duke përfshirë edhe platformën online vetëm sa e ndihmuan edhe më shumë bashkëpunimin dhe interaktivitetin trajner-student.”, ka thënë Lahu.

Kujtojmë që KEDS Academy ndihmon në punësimin e të rinjve dhe është një shembull për kompanitë tjera. Kjo akademi, që i ka hapur dyert për studentët e parë në vitin 2014, ka ndihmuar të rinjtë që përmes përvojave të fituara të gjejnë punë edhe në kompani tjera në vend, me shumicën në KEDS.

The Head of Training and Development at KEDS, Shemsije Lahu, also spoke to us about the progress of the project and the organization of the leadership program modules, as well as the technical one.

“Unlike with other generations, the last two generations, VII and VIII due to the circumstances created by the pandemic were organized differently (according to the instructions dictated by the Emergency Commission) by adapting different training tools and thus staying within the program planning as every year. This did not stop the progress at all and turned out to be just as successful. Because of the last year experience, it was easier with the VIII generation and we also had the opportunity to experiment with modules, always updating and bringing innovation to the program, Organizing differently including the online platform only helped further the coach-student collaboration and interactivity.”, said Lahu.

Let us remember that KEDS Academy helps hire young students and is an example for other companies. The Academy opened its doors to the first students in 2014, and has helped young people through their experiences to find jobs in other companies in the country and mostly in KEDS.

Asst. Prof. Dr. Tamer Atabarut, njëherësh Drejtor i Qendrës për Mësim Gjatë Gjithë Jetës, në Universitetin Boğaziçi të Stambollit, është pjesë e stafit ligjërues që nga krijimi i programit KEDS Academy.

Z. Atabarut nga këndvështrimi i tij përshkruan rëndësinë e programit, evoluimin nëpër vite dhe përkushtimin e studentëve gjatë proceseve mësimore.

“Programi i Lidershit të KEDS Academy ka nisur në fund të vitit 2013. Që nga fillimi programi kishte një qasje tjetër në modelin e mësimdhënies dhe të të nxënit. Ligjëratat interaktive janë mbajtur nga profesorë të shquar nga Universiteti Boğaziçi dhe më pas temat janë përpunuar nga menaxherët / ekspertët e KEDS me një punë praktike. Prandaj, programi i Lidershit të KEDS Academy u jep një mundësi unike pjesëmarrësve për të kombinuar praktikën dhe teorinë. Për më tepër, kurrikulat e programit dhe përmbajtja e moduleve të tij janë azhurnuar çdo vit duke marrë parasysh trendet lokale dhe globale, si Biznesi 4.0, Digjitalizimi, Siguria Kibernetike, Kriza Klimatike, etj.

Doja të theksoja se ky bashkëpunim i frytshëm i KEDS Academy mes KEDS dhe Universitetit Boğaziçi është shumë i vlefshëm dhe një praktikë e mirë e bashkëpunimit mes industrisë dhe universitetit.

Asst. Prof. Dr. Tamer Atabarut, at the same time Director of the Center for Lifelong Learning in Boğaziçi University in Istanbul has been part of the teaching staff since the establishment of KEDS Academy.

He describes the importance of the program, the evolution over the years and the commitment of students during the learning process.

She knew her village had an electric pole so she bought light bulbs, cables and other necessary items that were sold in another's village shop and brought them in her arms from the shop to her house.

Then, with the help of the only electrician in the village, her house was lit with electricity sometime around 1961-62. At first they had only four lights in the house, but they were enough to make life better than living in the dark. Nuhi Gjinolli also shows that in the beginning the electricity was weak.

"When it was installed at home, it was weak with only two wires, single-phase", says Gjinolli.


The day when the electricity installed for the first time in the homes of Kosovars is remembered quite clearly by those older generations, who experienced and noticed the change the most. Some remember the exact year, while some orient themselves according to the births of their children or important events to them.

"Unaccustomed to staying in the light, some of the family members also had mild eye pain when the electricity light came on for the first time," says 88-year-old Taibe Kastrati.

And she continues agreeing that, people's lives began to improve significantly after the introduction of electricity. The lights that were seen in every house, made the village full of life giving hope that humanity itself with the presence



**Adifete Berisha
Shehu
75 vjeçe**



**Nuhi Gjinolli
87 vjeç**



**Hanife Krasniqi
76 vjeçe**

shkonte drejt ditëve më të ndritshme.

Në Karaçevë të Epërme, fshat i komunës së Kamenicës, kujton zonja Kastrati, rryma ka ardhur për afërsisht në vitin 1967-68. Natyrisht që momenti kur janë lëshuar dritat për herë të parë ka qenë gëzim i papërshkrueshëm për të gjithë vendasit anekënd vendit.

“Qaq shumë na u ka ndryshu jeta për të mirë, si me na dhanë një palë krahë me fluturu,” shprehet, 76-vjeçarja Hanife Krasniqi nga fshati Rahovicë e Ferizajt. Sipas zonjës Hanife, në këtë fshat rryma ka ardhur rreth viteve 1971-1972.

“Fëmijët rrihnin shuplakë bërtitnin: ‘O po na vjen rryma! Atë natë i lamë dritat ndezë deri në mëngjes. Askush nuk donte t’i shuante.”

Përkthyer momentin e ardhjes së rrymës 72-vjeçarja Ramize Maliqi, e cila e kujton atë ditë lumëbardhë me shumë nostalgji. Sipas zonjës Ramize, rryma në fshatin e saj ka ardhur rreth vitit 1974.

Para se banorët e Kosovës të njoftoheshin me konceptin e energjisë elektrike ata ndriçonin dhomat e tyre në mënyra të ndryshme me kushte aspak të përshtatshme. Madje, disa nga këto mënyra ishin mjaft të dëmshme për shëndet për shkak të tymit që lironin. Metoda e parë që mbahet mend nga të moshuarit e intervistuar ka qenë kërcelli i një bime, që është

of electricity was heading towards brighter days. In Karaçevë e Epërme, a village in the municipality of Kamenica, recalls Mrs. Kastrati, the electricity was installed around the years 1967-68.

Of course, the moment when the lights were put on for the first time was an indescribable joy for all the locals all over the country.

"Our lives have changed so much for the better, like giving us a pair of flying wings" a 76-year-old lady Hanife Krasniqi from the village of Rahovica in Ferizaj says. According to Ms. Hanife, in this village the electricity was installed around the years 1971-1972.

"The children were slapping and shouting 'oh the electricity is coming. That night we left the lights on until morning. Nobody wanted to switch them off. "

Describes the moment of the arrival of electricity 72-year-old Ramize Maliqi, who remembers that happy day with a lot




Taibe Kastrati
88 vjeçe

mbajtur në duar nga një anëtar i familjes derisa anëtarët tjerë kanë ngrënë darkë.

“Edhe pse u digjke shpejt edhe bojke shumë tym, nuk kishim tjetër çka për me bo dritë natën.”
shton zonja Ramize.

Më vonë ata përdornin një teneqe apo gazishte, ku e vendosnin një fitil pambuku apo diçka tjetër që të digjet. Kjo metodë ka bërë më shumë tym sesa dritë gjatë djegies, sipas përshkrimit të atyre që e kanë përdorur.

Ndërsa tek më vonë, si forma të tjera për ndriçim të dhomave ka pasur llamba vajguri që mund t'i mbajmë mend edhe ne gjeneratat më të reja. Ndoshta mënyrë më e avancuar ka qenë feneri. E mira e fenerit ka qenë që së paku ka qenë i mbyllur përqark me xham për të mos u shuar, por edhe për të mos ndotur ajrin aty për aty. Të gjitha këto lloje të ndriçimit u përdorën derisa përfundoi elektrifikimi i plotë i vendit në vitin 1983.



Ramadan Ajvazi
79 vjeç



Ramize Maliqi
72 vjeçe

of nostalgia. According to Ms. Ramize, the electricity in her village was installed around 1974.

Before the residents of Kosovo were introduced to the concept of electricity, they lit their rooms in different ways with not at all suitable conditions. In fact, some of these ways were quite harmful to health because of the smoke they released. The first method remembered by the interviewed seniors was the stalk of a plant, which was held in the hands by a family member while the other members ate dinner.

"Even though it burned quickly and released a lot of smoke, we had nothing else to do to light up the night." Mrs. Ramize adds.

Later they used a tin or gas tin, where they put a cotton wick or something else to burn. This method has made more smoke than light during combustion, according to the description of those who have used it.

Later, as other forms of room lighting, kerosene lamps were used that we can also remember as the younger generations. Perhaps the most advanced way has been the lantern. The good thing about the lantern was that at least it was closed around with the glass so that it would not go out but also not pollute the air on the spot. All of these types of lighting were used until the complete electrification of the country was completed in 1983.

Ndonjëherë janë bërë edhe dallime gjinore, nëpër oda janë përdorur llambat dhe fenerët ndërsa te gratë 'gazishtet' që lironin tym.

"Kur kanë hangër bukë gratë i kanë përdorë do gazishte, që janë kanë si konzervë e mrena i kena qit gaz me dhez e dikush u dasht me e majt në dorë.", shprehet 76-vjeçarja nga Rahovica.

Këto forma të ndriçimit të hershëm bënë shumë pak dritë dhe nëse dikush donte, ta zëmë të thurte një palë çorape gjatë natës, aktivitet ky për të cilën nevojitej drita, ata duhej të afroreshin shumë te vendi ku ishte burimi i dritës ose duhej që dikush ta mbante burimin e dritës në dorë shumë afër, përndryshe ishte shumë errësirë për të parë e për ta përfunduar punën me sukses. Me ardhjen e energjisë elektrike gjërat u lehtësuan shumë. Në atë kohë shumica e popullatës merreshin me bujqësi. Gra e burra e nganjëherë edhe fëmijët e punonin tokën për t'u ushqyer me prodhimet e saj. Disa edhe mbillnin duhan. Ky i fundit shitej shtrenjtë dhe ndonëse procesi i punës ishte mjaft i vështirë, ishte fitimprurës. Energjia elektrike ju ndihmoi shumë që punët të kryhen më shpejt, sa që e gjithë familja tanimë punonte edhe natën në lidhjen e duhanit sipas zonjës Taibe, familja e të cilës është marrë me kultivimin e duhanit.

Por a e kanë ditur kosovarët se çka është energjia elektrike?

Ish-mësuesi Nuhi Gjinolli, 87-vjeçar, thotë se e ka ditur çka është rryma qysh herët se e ka mësuar në shkollë në lëndën e fizikës.

"Në vitet e 50-ta edhe 52-ta jom kon në Ferizaj në shkollë, kom ni për rrymë herët, qysh në klasën e pestë e kom ditë çka osht rryma."

Disa të tjerë shprehen që kanë dëgjuar për rrymën, po nuk e kanë ditë funksionin e saj, funksion ky i ndryshimit të jetës. Ramadan Ajvazi ka dëgjuar për herë të parë për rrymën para viteve të 50-ta.

Ai thotë se për herë të parë e ka parë rrymën në Hogosht të Kamenicës, në vitin 1958, të ndërtuar në formë të mullirit për të prodhuar rrymë.

Ndërsa në shtëpi të tij, në fshatin Kopërnice të së njëjtës komunë rryma u lëshua në shtator të vitit 1966.

Ndonëse kaloi pak kohë derisa banorët e Kosovës u pajisën me ndonjë pajisje elektrike, e para që shumica e të intervistuarve e mbajnë mend ishte masha që përdorej për ngrohjen e ujit. Më vonë ata patën edhe motor të ujit që ua lehtësoi punën jashtëzakonisht shumë, sidomos atyre që nxirrnin ujë me kova nga bunari. Pajisjet e tjera elektrike si të parat që i mbajnë mend janë: Reshov i vogël me një pllakë, radio e më pastaj edhe frigorifer.

E mira e së mirës ishte që energjia elektrike kishte ardhur dhe njerëzit tani po mësoheshin me të mirat që ajo solli në komunitet.

Sometimes gender differences have been made, lamps and lanterns have been used in the men's rooms- called Oda, while in women rooms were used 'gas tins' that have released smoke.

"When women ate, the women used gas canisters, filled in with gas and someone had to hold it by hand", said the 76-year-old from Rahovica.

These forms of early illumination produced very little light, and if one wanted to, for example, knit a pair of socks at night, an activity that required light, they had to get very close to where the light source was or someone had to hold the light source very close in his hand, otherwise it was too dark to see and finish the job successfully.

With the introduction of electricity things became much easier. At that time most of the population was engaged in agriculture. Women and men and sometimes even children worked the land to feed themselves. Some even planted tobacco. The latter was sold expensive and although the work process was quite difficult, it was profitable. Electricity helped them get things done faster, so much so that the whole family was already working at night on the tobacco tightening according to Ms. Taibe, whose family was involved in tobacco cultivation.

Did Kosovars know what electricity is?

Former teacher Nuhi Gjinolli, 87 year old, says that he knew what electricity was from the beginning because he taught it in school in the subject of physics.

"In the 50s and 52s I was at school in Ferizaj, I heard early on electricity, since the fifth grade I knew what electricity is."

Some others say that they have heard about the electricity, but they did not know its function, a function of life change. Ramadan Ajvazi first heard about electricity before the 1950s.


He said that he saw electricity for the first time in Hogosht of Kamenica, in 1958, built in the form of a mill to produce electricity.

While in his house, in the village of Kopërnica of the same municipality, the electricity was introduced in September 1966.


Although it took some time for Kosovo residents to be equipped with electrical appliances, the first thing most respondents remember was 'the fork heater' used to heat water. Later they also had a water motor which made their work extremely easy, especially for those who drew buckets of water from the well. Other electrical appliances as the first to remember are: a small portable single cook top electric stove, radio and then a refrigerator.

The good thing was that electricity had come and people were now getting used to the benefits it brought to the community.

www.kesco-energy.com



KESCO lanson uebfaqen moderne!



LIBRI, EFEKTI POZITIV I PANDEMISË NË KOSOVË

THE BOOK, THE POSITIVE EFFECT OF THE PANDEMIC IN KOSOVO

Pandemia e ka rritur leximin. Pra, edhe në Kosovë është ndjekur trendi i njëjtë i asaj se çfarë po ndodhë në botë gjatë kësaj periudhe të vështirë. Për të kuptuar për atë sa lexojnë kosovarët, flasim Edon Zeneli, botues nga Shtëpia Botuese dhe libraria Buzuku dhe koordinatori i librarisë Dukagjini, Liriana Hasaj.

Edon Zeneli nga Libraria Buzuku thotë se pikërisht shitja online është ajo që e ka bërë dallimin kualitativ. Duke qenë se virusi në kohën e karantinës pamundësoi kontaktin fizik dhe blerjet në librarë, shitja në masë është zhvendosur në atë online. Zbritjet u bënë që nga fillimi, ku në shumicën e ofertave u hoq kostoja shtesë për shërbimet e postës, duke e bërë edhe më të pëlqyeshme këtë formë të blerjes edhe pas hapjes së vendit.

"Ndonëse në fillim të pandemisë e gjithë bota u përball me një krizë të përgjithshme, përfshirë edhe leximin, muajt që pasuan rezultuan pozitiv për librin. Libraria jonë ofronte mundësinë e blerjes online duke i pranuar librat në shtëpi dhe po ashtu kemi bërë oferta të shumta me zbritje, duke ndikuar në kërkesë të shtuar. Lexuesi në anën tjetër sakaq kishte kohë me bollëk dhe këtë kohë e ka shfrytëzuar edhe për lexim," thekson Zeneli.

The pandemic has increased reading. So, in Kosovo, the same trend of what is happening in the world during this difficult period has been followed. To understand what Kosovars read, Edon Zeneli, publisher from the Buzuku Publishing House and bookstore, and the coordinator of the Dukagjini bookstore, Liriana Hasaj, speak.

Edon Zeneli from Buzuku Library says that online sales is what has made the qualitative difference. Given that the virus at the time of quarantine disabled physical contact and bookstore purchases, mass sales have shifted to online. Discounts were made from the beginning, where in most offers the additional cost for postal services was removed, making this form of purchase even more likable even after the opening of the country.

"Although at the beginning of the pandemic the whole world faced a general crisis, including reading, the months following this period of time were positive for the book. Our library offered the opportunity of online purchases by accepting books at home and we have also made numerous offers with discounts, affecting the increased demand. The reader, on the other hand, already had plenty of time and used this time for reading as well," Zeneli emphasizes.

"Çdo ditë duhet të dëgjojmë të paktën një këngë, të lexojmë një poezi të bukur, të shohim një pikturë të arrirë, dhe, nëse është e mundur, të flasim sa më pak!"

Johan Volfgang Goethe

Romani, sipas tij, vazhdon të mbajë pozitë dominuese, ndërsa është rritur interesimi për librat psikologjikë. "Lloji dominues i interesimit të lexuesve është romani, ndërsa vërehet një kërkesë e shtuar për titujt që kanë të bëjnë

The novel, according to him, continues to hold a dominant position, while interest in psychological books has increased. "The dominant type of interest of readers is the novel, while there is an increased demand for titles related to personal

me zhvillimin personal. Është shtuar nevoja e leximit të librave mbi psikologjinë, zhvillimin personal dhe shëndetin mendor. Dhe, titujt që kanë dominuar gjatë karantinës po edhe tash janë ata që evokojnë përvoja pandemike, si "Dashuria në kohërat e kolerës" dhe Murtaja, thotë Zeneli. Fatmirësisht, siç tregon Zeneli, të gjitha moshat janë të pranishme në kërkesa dhe blerje. Kjo në vijë të drejtë me demografinë e vendit tonë: Dominojnë moshat e reja me që ka më shumë të rinj, por nuk mungon asnjë moshë. Librat më të shitur përgjatë muajit shkurt te Buzuku kanë qenë: "Premtomë, baba" nga Joe Biden, "Murtaja" nga Albert Camu, "Dashuri në kohërat e kolerës" nga Gabriel Garcia Marquez, "Sekreti" nga Rhonda Byrne dhe "Alkimisti" nga Paulo Coelho.

Iliriana Hasaj nga libraria Dukagjini thotë se karantinimi ka ndikuar që të shtohet dëshira dhe kërkesa për libra, sidomos nga ata klientë që më herët nuk kanë blerë libra. "Meqenëse sivjet shënojmë një interesim me të madh të lexuesve për librin tek ne, duke krahasuar me vitin paraprak, prapëseprapë nuk mund të themi që është faktor pandemia, këtë vetëm mund ta hamendësojmë, sidomos duke pasur parasysh se te ne, sipas statistikave tona të brendshme, ka tash ca vite që çdo vit e me shumë është duke u shtuar numri dhe interesimi për libra", shprehet Hasaj.

development. The need to read books on psychology, personal development and mental health has increased. And, the titles that have dominated during the quarantine even now are those that evoke pandemic experiences, such as 'Love in times of cholera' and 'the Plague', says Zeneli. Thankfully, as Zeneli points out, all ages are present in demand and buying. This is in line with the demographics of our country: Young ages dominate with more and more young people, but no age is missing.

The best-selling books of February at Buzuku were: "Promise, Dad" by Joe Biden; "The Plague" by Albert Camu; "Love in the Times of Cholera" by Gabriel Garcia Marquez, "The Secret" by Rhonda Byrne and "The Alchemist" by Paulo Coelho.

Iliriana Hasaj from the Dukagjini bookstore says that the quarantine has increased the desire and demand for books, especially from those clients who have not bought books before. "Since this year we mark a greater interest of readers for the book in our country, compared to the previous year, we still can not say that the pandemic is the factor, we can only guess this, especially given that in our country, according to our internal statistics, it has been a few years now that every year more and more the number and interest for books is increasing", says Hasaj.

"Books are silent and permanent friends, they are the most acceptable and wise counsellors and the most patient teachers"

Charles Eliot





“Libri është ëndrra që mund ta mbash në dorë”

Neil Gaiman

Një përqindje pak më e madhe e lexuesve është rreth moshës 25-35 vjeçare, por interesimi, sipas Hasajt, është i shprehur nga të gjitha moshat. Edhe në këtë librari, shihen tendenca të ngjashme të lexuesve, mirëpo kanë parë ndryshime në preferencat e adoleshentëve e fëmijëve.

“Zhanret që kërkohen më së shumti janë librat këshillues/ motivues qoftë për jetën, karrierën a biznesin, pa lënë pas as romanet me tematika të ndryshme. Tek adoleshentët është shtuar shumë interesimi për Manga (stripa apo libra me ilustrime të stilit japonez). Kurse fëmijët preferojnë shumë serinë e librave si: Ditari i Gregut, Qeni njeri e Harry Potter,” shton ajo.

Librat më të shitur të shkurtit në Dukagjini janë nga fusha të ndryshme, duke filluar nga ata historikë deri te romanet dhe librat këshillues.

Në librarinë tonë librat më të shitur janë: “Rebelët, Besimtarët, të Mbijetuarit” nga Noel Malcolm, “Sekreti” nga Rhonda Byrne, “Abetare e Ilustruar e Prishtinës” nga Diellza Gojani, “Babai i Pasur Babai i Varfër” nga Robert Kiyosaki, “Arti i Brishtë i Not Giving a F*ck” nga Mark Manson, “Ti Je Placebo” nga Joe Dispenza, “Dashuritë e Mëdha nuk Veshin Fustan Nusërie” nga Mitsi Valaka, “Ditari i Gregut” nga Jeff Kinney, etj... Hasaj tregon se tash kur kemi një hapje të lehtë, me kujdes të shtuar, pjesa më e bukur gjatë punës së saj janë bisedat që ka me klientët të cilët ndihen të lirë të bisedojnë dhe të shprehin edhe kreativitetin edhe me pianon e librarisë.

A slightly larger percentage of readers is around the age of 25-35, but the interest, according to Hasaj, is expressed by all ages. Even in this bookstore, similar trends of readers are seen, but they have seen changes in the preferences of teenagers and children.

"The most sought after genres are advisory / motivational books whether for life, career or business, without leaving behind novels with different themes. Teenagers have a lot of interest in Manga (Japanese-style comics). "And the kids really like the series of books like Greg's Diary, Harry Potter, Dog Man," she adds.

The best-selling books of February in Dukagjini are from various fields ranging from historical ones to novels and advisory books.

*In our library the best-selling books are: "Rebels, Believers, Survivors" by Noel Malcolm, "Secret" by Rhonda Byrne, "Illustrated Abetare of Prishtina" by Diellza Gojani, "Rich Dad Poor Dad" by Robert Kiyosaki, "The Fragile Art of Not Giving a F * Ck" by Mark Manson, "You Are a Placebo" by Joe Dispenza, "Great Loves Do Not Wear a Wedding Dress" by Mitsi Valaka, "Greg's Diary" by Jeff Kinney, etc .. . Hasaj says that now that we have an easy opening, with added care, the most beautiful part during her work are the conversations she has with clients who feel free to talk and express both creativity with playing the library piano.*

"Të shumtë janë të rinjtë që çdo herë e më shumë kanë filluar të vijnë në librari qoftë për të kaluar kohën e lirë dhe shumë shpesh kemi dhe performanca muzikore shumë spontane aty për aty nga ta", ka thënë ajo.

Për Energy Info Hasaj e ka rekomanduar librin "Një natë në Lisbonë" nga Erich Maria Remarque, të cilën ajo aktualisht po e lexon.

Libri gjithmonë do të jetë i rëndësishëm për njerëzit, sidomos në kohë të vështira e të pasigurta. Kjo u vërtetua edhe gjatë kësaj pandemie, kur është shënuar një rritje e leximit që dëshmohet edhe nga shitja e madhe e librave në mbarë botën. Vetë situata e përgjithshme që i detyroi apo i inkurajoi njerëzit për të qëndruar në shtëpi, i ka shtyrë njerëzit edhe më tepër drejt leximit, kjo edhe ngase libri është ushqim shpirtëror që të ndihmon në të gjitha situatat.

Letërsia është lloj i artit në të cilin lexuesi është bashkëpjesëmarrës i autorit. Ai i lë hapësirë lexuesit, duke e ngacmuar imagjinatën e tij që ta paramendojë atë botë e personazhet. Prandaj, libri ka atë fuqi që t'ia lë lexuesit ta imagjinojë atë që shkrimtari nuk ka mundur ta paraqesë deri në fund.

"There are many young people who more and more have started to come to the library to spend their free time and very often we have spontaneous musical performances on the spot by them," she said.

For Energy Info Hasaj has recommended the book "A Night in Lisbon" by Erich Maria Remarque, which she is currently reading.

The book will always be important to people, especially in difficult and uncertain times. This was also confirmed during this pandemic, when there was an increase in reading which is also evidenced by the large sales of books worldwide. The general situation itself forced or encouraged people to stay home has pushed people even more towards reading, this also because the book is spiritual food that helps in all situations.

Literature is the kind of art in which the reader is the co-author of the author. He leaves room for the reader, stimulating his imagination to imagine that world and characters. Therefore, the book has the power to let the reader imagine what the writer could not present to the end.



"If you have set up a home library, you have given it its soul" Cicero

Një këshillë për ju

Gjatë tërë kohës bëjmë shumë gjëra njëkohësisht dhe kjo e ngarkon shumë mendjen tonë. Ndërsa kur lexojmë, e krijojmë mundësinë që të shkyçemi nga ato që na rrethojnë, andaj leximi është një mënyrë e shkëlqyeshme që të merremi me aftësinë tonë të përqendrimit në ç' mënyrë zhvillojmë dhe pasurojmë mendjen, njohuritë tona të përgjithshme e si përfundim edhe vetveten.

One advice for you

All the time we do many things at once and this puts a lot of strain on our minds. While reading, we create the opportunity to disconnect from those around us, so reading is a great way to deal with our ability to concentrate on how we develop and enrich the mind, our general knowledge and ultimately ourselves.

ALPINISTËT KOSOVARË QË PO SFIDOJNË PANDEMINË

KOSOVAR ALPINISTS CHALLENGING THE PANDEMIC

Nga bjeshkët, shtigjeve malore apo zbritjeve nga ndërtesat, ata i gjen kudo ku ka lartësi. Bëhet fjalë për Klubin Alpin Prishtina, të cilët gjatë pandemisë kanë ndryshuar kurs. Tashmë i gjen vazhdimisht në mbështetje të grupeve të ndryshme.

From mountains, mountain trails or rope descents from buildings, you can find them wherever there is a peak. It is about the Alpine Club Prishtina, who during the pandemic have changed course. Nowadays you find them constantly in support of various groups.





Gjendja e rënduar në mbarë botën ka bërë që i gjithë aktiviteti botëror të pësojë ndryshime dhe ngadalësime për shkak të pandemisë, që ka krijuar pothuajse një rend të ri botëror. Nga këto kohëra të vështira nuk kanë shpëtuar as sportet e ndryshme që kanë pushuar ose nuk kanë pasur mundësi organizimi të ndonjë evenimenti olimpik apo garë sportive. Kjo ka bërë që shumica e sportistëve të mos arrijnë objektivat dhe qëllimet e tyre në këtë kohë, duke zvogëluar në masë të madhe aktivitetet e tyre. Si të gjithë vendet e botës edhe Kosova ka hasur vështirësitë e saj në përballimin e pandemisë. Klubet dhe shoqatat sportive në Kosovë, nuk kanë shpëtuar nga kjo krizë, që ka ndikuar në realizimin dhe promovimin e aktiviteteve të tyre. Përshtatja me ligjet e reja anti-Covid, dhe adaptimin e aktiviteteve të tyre me ligjet e reja, ka qenë sfidë në vete e cila ka bërë që realizimi të jetë në një shkallë shumë të vogël, krahasuar me vitin paraprak.

Nga kjo gjendje e rënduar botërore nuk ka mundur të shpëtojë as sporti i alpinizmit që konsiderohet si një nga mundësitë më të mira që Kosova u ofron turistëve për shkak të rajoneve malore që posedon. Në këtë kohë pandemie edhe ky sport ka hasur në vështirësi të vazhdueshme për realizimin e objektivave të tyre, për shkak të rregullave të rrepta anti-Covid. Në ballafaqimin e tyre si klube të alpinizmit kanë hasur në disa probleme kyçe të cilat kanë obliguar klubet të ndryshojnë plan programin e tyre, si dhe të adaptojnë kërkesat në bazë të ligjeve të reja nga IKSHP.

The aggravated situation around the world has caused all world activity to undergo changes and slowdowns due to the pandemic, which has created almost a new world order. From these difficult times have not escaped even the various sports that have ceased or have not had the opportunity to organize any Olympic event or sports competition. This has led most athletes to not achieve their goals and objectives at this time, greatly reducing their activities. Like all countries in the world, Kosovo has encountered its difficulties in coping with the pandemic. Sports clubs and associations in Kosovo have not been excluded from this crisis, which has affected the realization and promotion of their activities. Adapting to the new anti-Covid laws, and adapting their activities to the new laws, has been a challenge in itself which has made the implementation to a very small degree, compared to the previous year.

The sport of mountaineering, which is considered one of the best opportunities that Kosovo offers to tourists because of the mountainous regions it possesses, could not escape from this aggravated world situation. In this time of pandemic, even this sport has encountered constant difficulties in achieving their goals, due to strict anti-Covid rules. In their challenges' as mountaineering clubs they have encountered some key problems which have obliged clubs to change their curriculum, as well as to adapt the requirements based on the new laws from the NIPH.



Si rrjedhojë, numri i turistëve ka pësuar rënie nga viti paraprak, për shkak të gjendjes aktuale, si dhe kufizimeve nga ligji anti-Covid. Nazmi Hasanramaj, i cili njëherësh është edhe përfaqësues i Klubit Alpin Prishtina, tregon në detaje se cilat kanë qenë sfidat kryesore me të cilat janë përballur ata në veçanti, mirëpo edhe beteja e alpinizmit kosovar me gjendjen pandemike.

“Aktivitetet e Klubit Alpin Prishtina gjatë vitit në fjalë kanë qenë më shumë improvizime dhe përshtatje me rregullat e IKSHP-së, por megjithatë kemi vazhduar me organizime sipas mundësisë dhe rrethanave. Me rëndësi ka qenë përpjekja për ruajtjen e vazhdimësisë së aktiviteteve dhe mbarëvajtjes së projekteve që kanë qenë duke u implementuar, por që gjatë pandemisë u ndryshoi platforma dhe modeli i implementimit”, thotë ai.

Ai tregon se numri i aktiviteteve që i kanë zhvilluar ka përbërë rreth 30% të aktiviteteve të përgjithshme, që përbëjnë programin tonë në vitet e rregullta. Këto aktivitete qenë të kufizuara edhe në pjesëmarrje, gjë që e ka zhvilluar një qasje të re ndaj programit të përgjithshëm.

Si rrjedhojë, z. Hasanramaj, njoftoi se mospjesëmarrja e mjaftueshme në aktivitetet e tyre si klub, ka bërë që aktiviteti kryesor ka qenë improvizimi dhe ruajtja e traditës dhe konceptit që ata si klub operojnë. Gjithashtu, kjo le të kuptohet se klubi si dhe sporti i alpinizmit në përgjithësi është përballur edhe me kriza financiare që kanë shtyrë klubet dhe shoqatat t'u drejtohen institucioneve më të larta udhëheqëse, në kërkim të ndihmës financiare që të përballohet sa më lehtë kjo krizë mbarë botërore.

Edhe Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë hapa konkretë në dhënien e ndihmave financiare, gjë që ka qenë e pamjaftueshme për tejkalimin sa më të lehtë të krizës, por gjithsesi shumë e mirëpritur nga klubet dhe shoqatat. Një nga pikat kyçe të klubit, sipas z. Hasanramaj, ka qenë dhe është edukimi i të rinjve në natyrë, gjë që konsiderohet si shumë e rëndësishme, pasi që rinia nuk është në dijeni për kapacitetet që ka Kosova për turizëm, si dhe ndihmon ata që të fitojnë njohuri konkrete se si duket Kosova dhe çfarë relievi posedon. Nga përshtatja e tyre me ligjet e IKSHP-së, dhe me masat e reja anti-Covid, klubi ka zhvilluar një sërë aktivitete

As a result, the number of tourists has decreased from the previous year, due to the current situation, as well as restrictions by anti-Covid law. Nazmi Hasanramaj, who is also the representative of the Alpine Club Prishtina, shows in detail what were the main challenges they faced in particular, and also the battle of Kosovo Alpinism with the pandemic situation.

“The activities of the Alpine Club Prishtina during the year concerned have been more improvisations and adaptations to the rules of the NIPH, but nevertheless we have continued with organizations according to the possibility and circumstances. It was important to try to maintain the continuity of activities and the progress of projects that have been under implementation, but that during the pandemic the platform and model of implementation changed,” he said.

He points out that the number of activities they have developed has accounted for about 30% of the total activities, which make up our program in regular years. These activities were also limited to participation, which has developed a new approach to the overall program.

Consequently, Mr. Hasanramaj, announced that the insufficient participation in their activities as a club, has made the main activity to improvise and preserve the tradition and concept that they operate as a club. Also, it should be understood that the club as well as the sport of mountaineering in general has faced financial crises that have pushed clubs and associations to turn to higher management institutions, seeking financial assistance to cope with this worldwide crisis as easily as possible.

The Government of the Republic of Kosovo has also taken concrete steps in providing financial assistance, which has been insufficient to overcome the crisis as easily as possible, but still very welcome by clubs and associations. One of the key points of the club, according to Mr. Hasanramaj, has been and is the education of young people in nature, which is considered very important, as young people are not aware of the capacities that Kosovo has for tourism, and helps them gain concrete knowledge of what Kosovo looks like and what landscape it possesses. From their compliance with the laws of the NIPH, and with the new anti-Covid measures, the Club has developed a series of activities compatible with the law.

të përshtatshme me ligjin. Gjatë vitit ata kanë qenë në gjendje të zhvillojnë aktivitete në sektorin e beshkatarisë, ku vlen të theksohen aktivitetet e hikingut me personat e verbër. Ndërsa në kuadër të sektorit të Edukimit të Fëmijëve në Natyrë, ka pasur aktivitete në kampe edukative në natyrë çiklizmi malor, gjithashtu ka pasur aktivitete, mirëpo të kufizuara gjatë kësaj kohe. Ndërkohë, një rëndësi të veçantë sipas z. Hasanramaj, ka pasur ofrimi i trajnimeve alpine, gjë që klubi i ka dhënë një fokus të shtuar.

During the year they have been able to carry out activities in the mountaineering sector, where it is worth noting hiking activities with blind people. While within the Children's Outdoor Education sector, there have been activities in outdoor education camps Mountain biking has also had activities, but limited during this time. Meanwhile, a special importance according to Mr. Hasanramaj has been given to the provision of alpine training, which the Club has given an added focus.

“Aktivitetet e Klubit Alpin Prishtina gjatë vitit në fjalë kanë qenë më shumë improvizime dhe përshtatje me rregullat e IKSH, por megjithatë kemi vazhduar me organizime sipas mundësisë dhe rrethanave”

“The activities of the Alpine Club Prishtina during the year concerned have been more improvisations and adaptations to the rules of the NIPH, but nevertheless we have continued with organizations according to the possibility and circumstances”, Nazmi Hasanramaj KAP(Alpine Club Prishtina).



FAKTE ENERGJETIKE PËR FËMIJË


ENERGY FACTS FOR KIDS

Për fëmijët tan




Parimet themelore të energjisë elektrike u zbuluan gjatë viteve 1820-1830 nga shkencëtari britanik Michael Faraday, i cili njihet si 'Babai i energjisë elektrike'.

The basic principles of electricity were discovered during the years 1820-1830 by the British scientist Michael Faraday, known as the 'Father of Electricity.'



Energjia elektrike vjen në shtëpinë tonë përmes linjave nëntokësore ose ajrore.



Electricity comes to our house through underground or overhead lines.



Energjia mund të prodhohet në forma të ndryshme, përmes qymyrit, erës, ujit, si dhe përmes diellit.



Energy can be produced in various forms, through coal, wind, water, as well as through the sun.




Nëse një zog qëndron në një tel elektrik, atëherë ai është i sigurt që nuk do të elektrizohet, mirëpo nëse zogu prek edhe një tel tjetër, atëherë zogu do të jetë në rrezik jete.

If a bird stands on an electric wire, then it is sure that it will not be electrified, but if the bird touches another wire, then the bird will be in danger of life.




Qymyri është burimi më i madh në botë përmes të cilit prodhohet energjia elektrike.

Coal is the largest source in the world through which electricity is produced.




Kosova bën pjesë në top 5 vendet e para në botë për rezervat e qymyrit.

Kosovo is one of the top 5 countries in the world for coal reserves.



Elektriciteti udhëton me një shpejtësi prej 300,000 km për sekondë.

Electricity travels at a speed of 300,000 km per second.






Elektriciteti është i pranishëm edhe në trupin tonë dhe është një nga faktorët kryesor që bën zemrën e njeriut të rrahë.

Electricity is also present in our body and is one of the main factors that makes the human heart beat.



Një rrufe nga qielli përmban rreth 3 milionë volt, që do të ishte e mjaftueshme për të furnizuar rreth 200,000 shtëpi me energji elektrike.

A lightning contains around 3 million volts, which would be enough to supply about 200,000 homes with electricity.




Makina e parë elektrike e suksesshme u ndërtua më 1891 nga shpikësi amerikan William Morrison.

The first successful electric car was built in 1891 by the American inventor William Morrison.



Rruga e parë në botë e ndriçuar me llamba elektrike ishte Mosley Street, në Angli në vitin 1879.


The first street in the world lit by electric lamps was Mosley Street, in England in 1879.





Termocentrali i parë filloi punën në vitin 1882. Ai ishte në pronësi të Thomas Edison.

The first power plant started operating in 1882. It was owned by Thomas Edison.





Energjia elektrike është shumë e rrezikshme. Asnjëherë mos iu afroni linjave të rrymës dhe mos i futni gishtat në priza elektrike.

Electricity is very dangerous. Never approach power lines or insert your fingers into electrical outlets.





Benjamin Franklin përmes studimeve të tij rreth energjisë elektrike zbuloi mbrojtësen nga rrufetë, të cilën duhet ta ketë të instaluar çdo ndërtesë apo shtëpi banimi.

Benjamin Franklin through his studies about electricity discovered lightning protection, which should be installed in every building or house.



Për fëmijët tan

GJENI 10 DALLIMET NDËRMJET DY FOTOVE FIND 10 DIFFERENCES BETWEEN TWO PICTURES



Qendra e Thirrjeve: 0800 791 00
info@kesco-energy.com
www.keds-energy.com
www.kesco-energy.com